

W  
R

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

## TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 23 TETOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 23. 10. 2003. GODINE

---

TETOR - OKTOBAR  
2003



**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike (2003 / 25),
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kadastër (2003 / 30),
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për barazi gjinore (2003 / 29),
5. Propozimi i rendit të ditës për Seancën plenare me 30 tetor 2003:
  - 5.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër diskriminimit,
  - 5.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin sanitari,
  - 5.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Pensionet e aftësisë së kufizuar.

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Друго разматрање Нацрта закона о изменама и допунама Закона о менаджирању јавних финансија и одговорности (2003 / 25),
3. Прво разматрање Нацрта закона о кадастру (2003 / 30),
4. Прво разматрање Нацрта закона о полној равноправности (2003 / 29),
5. Предлагаште дневног реда за наредну пленарну седницу (за дан 30 октомбар 2003. Године):
  - 5.1 Прво разматрање Нацрта закона против дискриминације,
  - 5.2 Друго разматрање Нацрта закона о санитарном инспекторату,
  - 5.3 Друго разматрање Нацрта закона о пензијама за ограничену способност.

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**AGENDA**

1. Review of the minutes from previous meeting,
2. Second review of the Draft Law on changes and amendments of the Law on Public Finances (2003 / 25),
3. First review of the Draft Law on Cadastre,
4. Review of the Draft Law on the Gender Equality,
5. Proposal of the Agenda for the Plenary Session on October 30, 2003:
  - 5.1 First Review of the Draft Law on Discrimination,
  - 5.2 First Review of the Draft Law of the Sanitary Inspectorate,
  - 5.3 Second Review of the Draft Law on the Disability Pensions.

# T R A N S K R I P T

## I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 23 TETOR 2003

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës – Prishtinë.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës. Bashkëkryesues Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,15.

### **KRYETARI I KUVENDIT:**

Mirëmëngjes të gjithë deputetëve dhe të të pranishmëve tjerë. Mirëseerdhët në Seancën e rregullt plenare.

Para se të kalojmë në shqyrtimin e materialeve, që i kemi marrë, për rend të ditës, më lejoni që, besoj edhe në emrin tuaj dhe të Parlamentit në përgjithësi, të bëj një prononcim si kryetar i Parlamentit lidhur me ndodhitë që po ngjajnë dhe ajo e së djeshmit – e ndalesës dhe arrestimit të komandantit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, gjeneral lejtnant Agim Çekut, ishte pikë e ujit në gotën e mbushur dhe jo vetëm që është derdhë e tërë sasia e ujit po është thyer edhe gota më.

Në vazhdimësi po krijohet një instabilitet i shtuar politik në Kosovë dhe këtë pa dëshirën dhe pa pjesëmarrjen e kosovarëve.

Ajo që për një vit e gjysmë si institucion e munduam ta bindim bashkësinë ndërkombëtare se në Kosovë po funksionon tërë gama e

pushtetit të një vendi fqinj, nuk jepte rezultate të duhura. Këtë edhe në Seancën plenare të Vienës u mundova me dokumentuar dhe fatkeqësisht u pa që kisha të drejtë.

Me fletarrest të një gjykate inekzistente, të një pushteti i nekzistent në Kosovë, u ndal dhe u arrestua prijësi i një prej institucioneve, siç e quajmë ne v itale dhe më të rëndësishme të Kosovës. Kjo i shte hera e dytë që prijësit e Kosovës të poshtërohen dhe me këtë, jo ata dhe dinjëteti i tyre individual, por Kosova, e kaluara e saj, e tashmja dhe e ardhmja e Kosovës.

Megjithatë, pas një nate të gjithë juve kolegë të nderuar dhe të Kosovës, është lajm i mirë që brenda bashkësisë ndërkombëtare ka njerëz shum të përgjegjshëm. Dhe, mirënjohjet tona i shkojnë të gjithë atyre që u munduan të ndikojnë pozitivisht, në veçanti mirënjohja i shkon zotit Hollkeri për shkak të angazhimit të tij të vendosur, këmbëngulës dhe frytdhënës. Kjo lë një vakum për institucionet tona, në veçanti për Parlamentin: – çka më tutje? Sfidat janë shum të mëdha. Përgjegjësitë tona të marra nga elektorati janë shumfishuar dhe ne duhet të sillemi konform atyre përgjegjësive. Ne, me rreziqe të caktuara, me çmime të larta por në interes të Kosovës, me bindje të thellë që në interes të Kosovës dhe qytetarëve të saj, ishim në anien e paqës me bashkësinë ndërkombëtare. Ne dëshirojmë të mbetemi bashkërisht në atë anie, për hirë të ardhmërisë së projektuar, të planifikuar dhe në strategji të paraparë të popullit të Kosovës. Por, jo më me këto sjellje.

Unë edhe në takimin që kisha me drejtorin politik të Ministrisë Suedezë, në mëngjes, shpreha pakënaqësi të madhe të institucioneve tona që, tepër herët dhe pa argumente valide, u hapën dyert e mëdha për Serbinë në institucionet e Evropës. Ne dëshirojmë që Serbia të jetë në Evropë, siç dëshirojmë që Kosova të jetë si vend, si shtet i pavarur në Evropë, por jo duke i poshtëruar qytetarët e njërit vend ose të vendit tjetër. Dhe kjo e vështirëson tejmase - tejmase pjesëmarrjen tonë në proceset e ç'tensionimit të situatës, të detantit në rajon.

Unë, në fillim të mandatit tim, kam kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare që prijësit e institucioneve të Kosovës duhet të kenë dokumente udhëtimi me të cilët mbrohet dinjëteti dhe identiteti i

institucioneve të Kosovës, dhe i njerëzve që iu prijnë proceseve demokratike në Kosovë. Nuk u gjend zgjidhje. Kësaj radhe arsyet janë shum më të fuqishme që të kërkojmë, që të kërkojmë dokumente udhëtimi diplomatike për të gjithë ata që i paraprijnë proceseve demokratike në Kosovë dhe në qoftë se bashkësia ndërkombëtare, si mision i saj në Kosovë, nuk është në gjendje ta sigurojë këtë – ne duhet seriozisht – seriozisht t'i rishqyrtojmë pozicionet tona ose të kërkojmë zgjidhje që janë në fryshtë të përgjegjësive që i kemi dhe të detyrate që duhet t'i kryejmë para qytetarëve të Kosovës.

Në të njëjtën kohë, i ftoj qytetarët e Kosovës që vërtetë të jenë të dinjitetshëm, siç kanë dijt dhe siç dijnë të jenë dhe ne nuk kemi nevojë që të kërkojmë ashpërsimin e marrëdhënieve me Slloveninë ose me ndonjë vend tjeter.

Institucionalisht, me përgjegjësi, siç është punuar, dhe unë i falënderoj të gjitha institucionet që tërë pasditën dhe natën kemi punuar aq sa është takati ynë që të kontribuohet për zgjidhje pozitive.

Prandaj, t'i kthehem i punës në Parlament, në institucionë dhe në Kosovë e të vazhdohet progresi me një qetësi, dhe të kemi sjellje ndaj të gjithë qytetarëve të Kosovës ashtu siç kemi pasur edhe deri tanë dhe të vazhdojmë proceset demokratike.

Unë mendoj se me këtë duhet ta përmbyllim dhe të kalojmë në shqyrtimin e materialeve që i kemi në rend të ditës.

Ka kërkesa nga të gjitha palët për t'u paraqitur, po e shoh, por ka edhe nga të gjitha grupet... Urdhëroni Bujar.

## **BUJAR DUGOLLI:**

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Përkundrazi fjalimit që e mbajtët, unë mendoj se nuk është i majftueshëm karshi këtij provokimi dhe provokimeve të vazhdueshme

që po i bën Beogradit zyrtar karshi qytetarëve të Kosovës dhe bartësve të institucioneve.

Ne mendojmë që në këtë seancë, si çështje e ngutshme, të futet kjo çështje – çështja e ndodhisë së djeshme dhe Kuvendi të reagojë në mënyrë institucionale, jo përmes këshilltarëve, dhe njëkohësisht të kërkohet nga Qeveria e Kosovës që t'i dërgojë notë proteste Qeverisë së Sllovenisë, po ashtu Qeverisë së Beogradit që t'i shuajë njëherë e përgjithmonë ato institucion paralele, që janë institucion kriminale, që janë të trashiguara nga periudha e Millosheviqit e deri më tash. Sa për një shembull, e ashtuquajtura gjykatë e qarkut e Prishtinës, që udhëheqet nga kriminelja Danica Marinkoviq, e cila me urdhërin e vet në gjykatën hetuese, të paktën tre të burgosur politik i ka mbyt me torturë si: Besnik Restelicën, Rexhep Bislimin, Cen Dugollin. Ajo është kryekriminale, e cila bën akuza ndaj njerëzve, ndaj veprimtarëve, ndaj bartësve të institucioneve që mundohen ta instalojnë një paqë dhe qetësi në Kosovë.

Ne nuk mund t'i tolerojmë këto veprime dhe t'i kalojmë sikur s'ka ndodhur asgjë. Ne mendojmë që duhet Kuvendi i Kosovës të dalë, të reagojë zyrtarisht përmes një deklarate, pasi t'i dëgjojë propozimet edhe të grupeve tjera parlamentare dhe Qeveria duhet zyrtarisht t'i drejtohet këtyre dy qeverive me notë proteste.

Njëkohësisht, nga zoti Hollkeri të kërkohet, në një seancë të ardhshme, që të vjen para këtij Kuvendi dhe të shihet çka është duke bërë ai zotëri për mbrojtjen e dinjitetit të qytetarëve të Kosovës. A edhe më tutje do të vlejnë akuzat e gjykatave kriminale serbe mbi qytetarët e Kosovës dhe, saherë ata të kenë dëshirë, të ngrisin akuza dhe të ndalin njerëz tanë në udhëtime që i bëjnë jashtë vendit.

Thjesht, ne jemi qytetarë pa liri, pa liri të lëvizjes dhe më nuk mund të tolerohet. Duhet t'i lënë ato demagogji dhe të vijnë të thonë që Kosova a është duke u administruar nga ndërkombëtarët dhe a kanë përgjegjësi ndërkombëtarët për këta qytetarë, apo është duke u administruar nga Serbia.

Kjo çështje nuk mund të kalojë vetëm me një fjalim. Duhet të dëgjohen edhe diskutimet e grupeve tjera parlamentare dhe në fund duhet të jetë

një dokument zyrtar i Kuvendit të Kosovës që edhe Qeverinë do ta autorizonte t'i marrë masat e duhura dhe njëkohësisht nga UNMIK-u të kërkojmë n'seancën e ardhshme të radhës të vjen dhe të japë përgjegjësi për këto veprime të ulta. Ju falemnderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT:**

Ju falemnderit. Zoti Berat Luzha, në emër të Grupit Parlamentar të PDK.

### **BERAT LUZHA:**

Zoti kryetar,

Jemi dëshmitarë të provokacioneve të vazhdueshme të pushtetit serb ndaj Kosovës, në këtë radhë edhe të organeve shtetërore të Sllovenisë. Grupi Parlamentar i PDK propozon që të bëhet një deklaratë, një protestë zyrtare drejtuar organeve shtetërore të Sllovenisë dhe të kërkohet nga zoti Hollkeri, nga Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara që të ndërmarrë masat e fundit, më të ashpra, kundër institucioneve paralele të shtetit të Serbisë, të cilat i ka në Kosovë. Ju të gjithë e keni lexuar raportin e OSB-esë, në të cilin flitet se të gjitha organet shtetërore të Serbisë, duke përfshirë edhe SUP-in – sekretariatin e punëve të brendshme të Serbisë funksionojnë në Kosovë. Madje, jo vetëm në Serbi por edhe brenda në Kosovë.

Kështu që, është koha, është momenti që këto institucione të shuhen. Pérndryshe, Serbia tregon se vazhdon politikën e Millosheviqit ashtu siç ka qenë atëherë dhe nuk është e gatshme dhe nuk i plotëson kushtet për një dialog të mirëfilltë me Kosovën. Ju falemnderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT:**

Ju falemnderit. Zoti Nojkiq, në emër të Koalicionit «Kthimi».

## **RANDJEL NOJKIĆ:**

Radno predsedništvo, dame i gospodo,

Gospodine predsedniče ja moram pre svega da se ogradim... Vi ne govorite u ime celokupne Skupštine Kosova i metohije, govorite o jednoj većoj parlamentarnoj većini i, ja vas molim, da se vi tako i ponašate. Vi ste prilikom vašeg odlaska u Beću i vi i gospodin Rugova takodje zastupali jednu većinsku grupu a ne sve članove odnosno celu populaciju Kosova i metohije. Ne možete na ovaj način da diskriminišete, jeste i do sada to činili da diskriminišete jednu veću grupaciju ovde koja je takodje veoma važna i koja je dobila poverenje odredjenih gradjana Kosova i metohije.

Govorite o tome da moraju da odgovaraju za ratne zločine, prema tome za ratne zločine moraju da odgovaraju svi. Vi znate da je na prostorima Kosova i metohije da su stradali i srbi i albanci i romi i svi ostali. Prema tome ako ima stradalnika onda ima i onih koji su odgovorni za to. Normalno je da država u kojoj živimo mora pre svega da traži da zaštitи svoju zajednicu na ovom prostorima. Prema toma, ostavimo to, neka to pravovosudje i neka medjunarodna zajednica da o tome sud, nemojte da dajete vi sud i nemojte vi da govorite, ili ako govorite onda govorite u vaše lično ime i u ime parlamentarne većine koju predstavljate. Mi, na ovaj način, zaista moraćemo da se ogradimo od vas i od vaše diskusije i vi nikako, niti ste u Beću zastupali tamo interes svih gradjana niti ovde zastupate interes gardjana i to je jedna klasična diskriminacija jedne važne parlamentarne grupe u Skupštini Kosova i metohije.

## **KRYETARI I KUVENDIT:**

Vetëm një moment...

Unë i kuqtoj vështirësitë e Nojkiqit që nuk ka jetuar, nuk ka dashur të kyçet në një sistem demokratik, prandaj edhe rregullat elementare të demokracisë, të shumicës demokratike nuk është në gjendje me i kuptuar.

Nga ana tjeter, gjenrali ynë i rrespektuar, nuk është ndaluar, nuk është arrestuar me kërkesë të bashkësisë ndërkombëtare dhe kjo është krejtësisht e pavërtetë që e thotë zoti Nojkiq. Sa për procesverbal, jo për të polemizuar.

Prandaj, unë mendoj që plotësisht pajtohem, në qoftë se mendoni se grupet parlamentare të nxjerrin, unë e thash, në emër të Parlamentit si kryetar i Parlamentit, dokument që është regjistruar dhe dokument që ka fuqi të plotë parlamentare. Është një deklaratë zyrtare. Nuk e thash unë ndryshe. Dhe, në qoftë se mendoni që diçka është lëshuar, grupet parlamentare mund ta plotësojnë dhe pajtohem, por nuk pasq që diçka të re ose që nuk e përfshira... Megjithatë, është e hapur dhe unë mundem në ç farëdo forme që të paraqet Parlamenti, jam i gatshëm tа procedoj dhe rrespektoj.

Prandaj, e ka fjalën zoti Hamiti.

### **SABRI HAMITI:**

Zotni kryetar, kolegë të çmuar,

Këtu, para se të hapet rendi i ditës, u hap një temë, po ashiqare që e hapë aktualiteti konkret, një temë e dhembshme, që ka të bëjë me raportet tona me jashtë dhe me sjelljet ndaj njerëzve tanë, në këtë rast ndaj përfaqësuesve. Ju duhet ta dini sa është e egër kjo sjellje ndaj njerëzve, që i quajmë në zhargonin e përditshëm të zakonshëm, kur merr peshën dhe karakterin e këtillë ndaj personave përfaqësues.

Unë mendoj që është mirë të reagohet edhe kështu. Mirëpo, Kuvendi, si një organ shumpërgjegjës, edhe para zgjedhësve të vetë, edhe para përfaqësimit politik të Kosovës – nëse do të marrë një qëndrim në formë të shkruar është mirë që të marrë qëndrim pak a shum kësisoj:

Kuvendi kërkon çfuqizimin e të gjitha akteve që i ndërmerr Serbia ndaj qytetarëve të Kosovës dhe ky çfuqizim, në formë të artikuluar me shkrim, t'u dërgohet qeverive evropiane, edhe Interpolit edhe Evropolit.

Dhe, kjo do të ishte, unë kujtoj, veprimi më i fortë institucional sesa ne të bisedojmë për rastet që ndodhin dhe për komentimin e tyre. Ju falemnderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT:**

Ju falemnderit. Në qoftë se jemi të pajtimit, unë mund ta jap një pauzë. Po e shoh se kam përkrahje të grupeve parlamentare. Formulone, e aprovojmë atë dokument dhe vazhdojmë me rendin e ditës. Gjysmë ore pauzë, ju lutem.

**(Vijon pauza)**

**(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)**

### **KRYETARI I KUVENDIT:**

Mendoj se janë plotësuar të gjitha kushtet për ta vazhduar Seancën plenare. Grupi, i përbërë prej grupeve parlamentare, ka kryer punën. Kanë sjellë një deklaratë – dokument dhe unë lus zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të tyre, ta marrë fjalën. Ju lus për qetësi. Urdhëroni:

### **NEKIBE KELMENDI:**

I nderuari kryetar,

Më lejoni ta lexoj formulimin e deklaratës, të grupit punues që u themelua ad hok për formulimin e kësaj Deklarate.

KUVENDI I KOSOVËS  
23 tetor 2003  
Prishtinë

Kuvendi i Kosovës, i shqetësuar për arrestimin e Komandantit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, gjeneral lejtnant Agim Çeku, si dhe për arrestimet e mëparshme të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, e të qytetarëve të saj, duke kundërshtuar funksionimin e organeve paralele serbe në Kosovë e në Serbi, të emërtuara si gjykata të Kosovës, miraton këtë

### D E K L A R A T Ë

Kuvendi i Kosovës i konsideron të pavlefshme të gjitha fletëarrestet, vendimet gjyqësore dhe ekzekutimet e këtyre vendimeve që bëhen nga institucionet e Serbisë dhe nga organet gjyqësore paralele serbe, të cilat funksionojnë në territorin e Kosovës e të Serbisë dhe kanë të bëjnë me qytetarët e Kosovës.

Kuvendi kërkon nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë dhe jasht saj, duke përfshirë Interpolin dhe Evropolin, që të mos i njohin këto vendime dhe fletëarreste serbe kundër qytetarëve të Kosovës, sepse Kosova është nën jurisdikcionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe ka institucionet e veta demokratike.

Kuvendi kërkon nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, zoti Harry Hollkeri që të ndërmarrë veprime urgjente për zhbërjen e institucioneve paralele në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës proteston ndaj veprimit të organeve shtetërore të Sllovenisë lidhur me arrestimin e djeshëm të Komandantit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, gjeneral lejtnant Agim Çeku.

## **KRYETARI I KUVENDIT:**

Ju falemnderit, zonja Kelmendi.

Dëgjuam propozimin e grupit punues për këtë çështje. Unë ftoj Kuvendin të deklarohet.

Kush është për këtë tekst? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Është një votë kundër. Ju falemnderit.

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Prandaj, konstatoj që Deklarata është aprovuar, me një votë kundër dhe pa asnjë abstenim të të pranishmëve në sallë. Ju falemnderit.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For ..... Shumica – Vecina – Majority.....
  - Kundër – Protiv – Against..... 01 .....
  - Abstenime – Uzdržani – Abstained..... 00 .....
- 

Vazhdojmë me rendin e ditës së seancës.

Në rend dite është – Miratimi i Procesverbalit.

Unë ju lus që të jetë procedurë e aprovuar. Në qoftë se ka shqetësimë ose për përmirësimë le të dorëzohen me shkrim.

Dhe nën dy, kemi:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerëuar se Projektligji për ndryshimin e Ligjit numër 2003/2 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, ka bazueshmërinë juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerëuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin e Ligjit numër 2003/2 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, nuk përmban implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerëuar se Projektligji për ndryshimin e Ligjit numër 2003/2 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Prandaj, vazhdojmë me aprovimin e amendamenteve të propozuara:

Amendamenti 1 , Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Dy abstenime.

Prandaj, konsideroj se është aprovuar amendamenti.

Amendamenti 2 , Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Tre abstenime.

Prandaj, konsideroj se edhe ky amendament është aprovuar.

Dhe, në fund, na mbetet t'i aprovojmë si tërësi këto ndryshime.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Dy abstenime.

Konsideroj se, me dy abstenime, janë aprovuar të gjitha këto ndryshime.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For..... Shumica – Vecina – Majority.....
  - Kundër – Protiv – Against ..... 00.....
  - Abstenime – Uzdrzanih – Abstained..... 02.....
- 

Pika e tretë është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kadastrin.

Po kërkoj falje, duhet ta bëjmë një ndërrim në rendin e ditës, derisa të kthehet ministri përkatës, sepse ka paralajmëruar që do të kthehet.

Prandaj shkojmë në:

- Shqyrtimin e parë të Projektligjit për barazi gjinore.

Lus propozuesin e ligjit, le ta marrë fjalën. Urdhëroni...

## **MELIHA TE TËRMKOLLI:**

Të nderuar deputetë, i nderuar kryetar, të nderuar pjesëmarrës,

Duke qenë se Komisioni për barazi gjinore i Kuvendit të Kosovës është sponzorizues i Projektligjit për barazi gjinore, unë marr përgjegjësinë por edhe të drejtën që në emër të këtij Komisioni, t'i them dy-tri fjalë lidhur me këtë Projektligj.

Në kohën e ndryshimeve të mëdha që ndodhën dhe po ndodhin në Kosovë, me ndërtimin e një sistemi të ri politik e juridik të vendit, dimensioni i barazisë gjinore nga të shtruarit krejt sipërfaqësor dhe rang ndihme, ka marrë karakterin e një çështje serioze të trajtimit institucional, duke ngritur këtë çështje në nivelin e trajtimit ligjor.

Në botën bashkëkohore demokratike, si dhe në vendet e transacionit, ku bën pjesë edhe Kosova, çështja e barazisë gjinore, përfshirë edhe rregullativën ligjore dhe mekanizmat institucional, është bërë një nga kriteret më të rëndësishme të vlerësimit të shkallës së demokratizimit dhe prosperitetit të një vendi.

Duke qenë pjesë e kësaj bote, me synime të një vendi të pavarur dhe demokratik, me një traditë të pasur kodifikuese për kohën, madje edhe për raportet gjinore, të cilat kanë evoluar në shkallën më të lartë, sot është shtruar para nesh si çështje e një rëndësie të veçantë që ky evoluim të sanksionohet dhe të avancohet edhe përmes mbrojtjes dhe rregullimit ligjor të saj.

Nisur nga ky përcaktim, Komisioni për barazi gjinore i Kuvendit të Kosovës ka marrë përgjegjësinë për hartimin dhe përgatitjen e Projektligjit për barazi gjinore me qëllim të rregullimit, mbrojtjes, zhvillimit dhe sanksionimit ligjor të barazisë gjinore si një nga kualitetet fundamentale dhe nga më të rëndësishmet për zhvillimin, ndërtimin dhe demokratizimin e vendit dhe institacioneve demokratike.

Që në fillim dua të përmend dy veçanti të rëndësishme të Projektligjit për barazi gjinore.

E para, se është Projektligji i parë i përgatitur nga Kuvendi i Kosovës, konkretisht nga Komisioni për barazi gjinore i Kuvendit të Kosovës, i ndihmuar edhe nga ekspertë, dhe

E dyta – se është Projektligji i parë në historinë politike, juridike e legjislative të Kosovës, i cili rregullon këtë fushë me një ligj të veçantë.

Objektivat e këtij Projektligji janë të qarta: normimi, rregullimi dhe sanksionimi i barazisë gjinore në fushën publike të jetës dhe veprimit, si dhe ndërtimi e forcimi i mekanizmave për zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në të gjitha nivelet e organizimit institucional dhe organizimeve tjera dhe në të gjitha strukturat brenda këtyre niveleve.

Ne sot pasurojmë traditat më të mira me rregullat dhe parimet e standardeve ndërkombëtare, natyrisht duke u kujdesur për veçantitë e vendit të kushtëzuara dhe të limituara nga shum faktorë, në radhë të parë nga shkalla e zhvillimit ekonomik.

Me këtë ligj pretendohet edhe të marrë fund gjithajo zhurmë e madhe rrëth barazisë, apo thënë më sakt – pabarazisë, duke derdhur edhe mjete të mëdha në emër të saj por pa hyrë asnjëherë në esencën e çështjes.

Projektligji për barazi gjinore, iu referohet të dy gjinive dhe nuk është thjesht Projektligj për të drejtat e gruas, ndonëse, në masë të madhe vëhet në funksion të avancimit të pozitës së gruas si gjini më pak e përfshirë në të gjitha sferat e jetës, e me këtë edhe si gjini më pak e faktorizuar në këto sfera dhe në proceset e vendosjes.

Natyra e Projektligjit është më tepër afirmative, në kuptim të krijimit të mundësive për arritjen e barazisë gjinore, në raport me aftësitë dhe mundësitë e secilit individ apo thënë më ndryshe - është Projektligj me të cilin përcaktohet që për arsyet e përkatësisë gjinore askush të mos pengohet në fitimin dhe shprehjen e aftësive dhe mundësive për të dhënë kontributin e vet dhe për të marrë përgjegjësitë përkatëse. Sepse, barazia si dhe vetë liria, nuk është vetëm e drejtë. Para se gjithash, ajo është edhe përgjegjësi.

Avancimi i pozitës së gruas, sipas këtij Projektligji, ka kuptimin dhe është vetëm në funksion të arritjes së barazisë gjinore dhe në asnje mënyrë si ndërrim i vendeve apo tendencë dominimi në shoqëri.

Kuota aq shum e përfolur dhe njëkohësisht aq shum e preferuar, madje edhe në vendret siç janë Gjermania, Franca, Italia, e së fundi edhe Parlamenti Evropian, e paraparë edhe në këtë Projektligj, nuk është qëllimi i Projektligjit dhe as qëllimi i barazisë gjinore. Kuota është një mjet për arritjen e barazisë gjinore dhe atë mjet i karakterit transicional, që do të pushojë të jetë mjet i tillë kur plotësohen qëllimet e ligjit.

Në hartimin e Projektligjit janë rrespektuar dhe inkorporuar parimet e standardeve ndërkombëtare, të parapara me aktet dhe konventat ndërkombëtare me të cilat rregullohet fusha e barazisë gjinore dhe e të drejtave të barabarta.

Me këtë rast, unë dua që t'i falënderoj të gjithë ata, të cilët, në çfarëdo mënyre kanë dhënë kontributin e tyre, qoftë drejtpërdrejt apo indirekt, që ky projektligj të jetë sa më kualitativ.

Anipse Komisioni është hartues i këtij Projektligji, unë dua që të falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit, të cilët kanë punuar me një përkushtim të madh. Në veçanti falënderoj ekspertët, magjistër Hasnije Ilazin, ligjeruese në Fakultetin Filozofik, doktor Edit Harxni, këshilltare politike në Shtyllën e dytë të UNMIK-ut dhe Idriz Tahirin, këshilltar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës për përkushtimin dhe ndihmën e madhe profesionale për Projektligjin.

Falënderoj po ashtu institucione dhe organizata joqeveritare të Kosovës dhe ndërkombëtare, mekanizmat e OSBE-s, të UNMIK-ut, NDI, KCSF, UNIFEM, e të tjera.

Dhe krejt në fund, që ndoshta do të duhej të ishte krejt në fillim, falënderoj Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, në veçanti kryetarin Daci, i cili që nga fillimi ka mbështetur fuqimisht punën e përgjithshme të Komsionit, e sidomos punën rreth Projektligjit. Ju falemnderit.

## **KRYETARI I KUVENDIT:**

Ju falemnderit shum M elihate. Unë d ua edhe një kompliment t'ia bëj. Është Projektligji i parë i sponsoruar nga komisionet e Parlamentit dhe me këtë hapet një perspektivë e ardhshme që në ato pjesë ku nuk kemi sponsorime komisionet të aktivizohen. Ju falemndnerit.

Hap debatin për shqyrtim të parë. E ka fjalën profesor Sabri Hamiti.

## **SABRI HAMITI:**

A po e shihni sa është i këndshëm! Ne sot, këso atmosfere, kemi bërë edhe në mbledhjen e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës s iç veprojmë gjithnjë, por ligjet kur a provohen në parim d he kemi diskutuar, dhe si kryetar i Grupit Parlamentar e kam detyrë të Grupit Parlamentar që ta mbështes ligjin në parim. Dhe unë besoj se e kam bërë në mënyrën më të sakt. Me zemër e me mendje. Dhe këtu pushon ajo detyrë që i përfaqësoj të gjithë.

Unë shfrytëzoj rastin që t'i them disa fjalë për këtë ligj, të cilin e kemi përpala. Domethënë e përkrahim në parim dhe ne besojmë se shumëka në të mund të precizohet dhe të rindërtohet deri në fazën e aprovimit të tij.

Për mua është një sprovë interesante që t'i them disa fjalë këtu, para të gjithëve, për një tip të tillë ligji. Në një formë herë duket se është modë, herë është nevojë dhe unë besoj se edhe ne jemi në vijën e rezonimit të këtyre dy problemeve kur ndërtojmë ligje të këtilla që janë të natyrës së veçantë, dhe të natyrës së veçantë unë besoj në të gjitha legjislacionet botnore. Nuk është gjë jo e zakonshme që të hartohen ligje të tillë për barazinë e gjinive. A, si formulim.

Dhe unë bile te ne, konsideroj që ky problem më nuk është vetë problem konstitucional po prekë edhe problemin psikologjik dhe problemin, do të thosha social dhe kjo u pa edhe në reagimin tonë të parë në mesveti, por edhe në diskutimet rreth këtij ligji.

Pse e them këtë? E them se është mirë që të thyhen këto bariera dhe në të njëjtën kohë të mendohet thellësisht për problemet sociale-psikologjike të një ambienti dhe për atë formulën e famshme që ligjet me gjithatë janë burimore nga ambienti pa marrë parasysh universalitetin e tyre. Përndryshe, s'do të kishte nevojë të hartohet hiq. Kjo nevojë, do të thosha socio-psikologjike dhe konstitucionale e hartimit të këtij ligji ka depërtuar dhe në diskursin e ligjit dhe ju do të shihni vazhdimisht kemi: duhet, patjetër; të cilat në një ligj që shkruhet në mënyrën dëftore, sepse dëftorja e thotë obligimin dhe të vërtetë, ato shprehje s'vyjnë kurgjë. Domethënë është... militantizmi politik ka hyrë brenda në ligj për shkak të situatave socio-psikologjike, që po i quaj unë - konstitucionale që na popullojnë të gjithëve.

Unë mendoj, në leximin tjetër të gjitha këto hiqen se duhet, e në ligj s'thotë kurgjë. Thotë, kjo është kjo - ligji dhe është obligative. Domethënë ka hyrë një stresë militantizmi brenda për shkak të situatave që i kemi. Kjo në parim.

Nën dy. Ligji pritetendon në mënyrë s'hum të organizuar që ta jepë një materie, të propozojë rregulativën dhe të propozojë instrumentet, unë do të thosha, për herë të parë qeveritar në mënyrë që të përcillet materia. Këtu janë propozuar dy organe që s'ekzistojnë deri tash, një që quhet zyra për barazi gjinore pranë Qeverisë, si zyrë – institucion qeveritar dhe një që quhet avokati ose avokatja, u mor vesh a: ose avokatja ose avokati, varet, se janë dy gjinitë.

Këtu, sa më përket mua, unë e kam lexua, iu thash kolegëve, ligjin me qiri e me pishë në kutimin figurativ dhe të vërtetë. Një, se s'kishte rrymë dhe dy: që e kam lexuar germë-përgermë. Dhe kam disa vërejtje të cilat do të materializohen kur t'bisedojmë nen për nen.

Por unë shtroj vetëm dy-tri elemente themelore. Pika themelore, do të thosha zbatuese që kërkon ligji është nen 3.2 i cili thotë: "quhet diskriminim, osë nuk është barazi gjinore aty ku cilado prej tyre është më pak se 40%". Kështu thotë ky nen 3.2, i cili masandej bëhet çelës për projekte të tillë edhe në Qeveri, edhe në përfaqësim, edhe në pjesëmarrje, edhe në sanksionime - nëse s'mbërrihet kjo, e tjera – e tjera. Domethënë që ka konsekuenca në disa nene tjera, në disa pika tjera.

Unë për kuota, ju e dini qëndrimin tim, s'e ndërroj as sot, më pengojnë kudo në botë për cilëndo gjini, sepse nuk është problemi kush mbetet 40, s'ka lidhje, mundet njëra t'mbetet 40 ose tjetra. Por kushdo që mbetet 40, ose e fiton 60-shin, idhnohet, thotë: – po dua me i fitue 70 tash. Pse po m'i ndalë ti me i bë 70. Ose, ky tjetri, a? Keni kujdes. Kuota është... Mendohet se siguron liri, por nuk është e vërtetë. Saherë të qitet është dogmatike. Mendoni mirë për këtë kur ta lexoni. Nën një.

Dhe, nën dy. Unë mendoj se duhet të mendojmë si të krijohet konkurrenca në barazi. A krijohet konkurrenca e vërtetë me kuota!? Ju falemnderit.

### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit zoti Hamiti. Në emër të PDK, Hatixhe Hoxha. Urdhëroni.

### HATIXHE HOXHA:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Do të dëshiroja të theksoj faktin se Projektligji për barazi gjinore është njëri ndër ligjet e para që vjen në Kuvend nga kjo fushë. Me këtë ligj pretendohet të rregullohet një fushë shum e rëndësishme e jetës sonë: të drejtat dhe mundësitë e barabarta gjinore.

Për arsy se në fushën e barazisë gjinore e kemi një boshllék të ndjeshëm legjislativ, me këtë ligj synohet të përbushet kjo zbraztësirë ligjore. Ky ligj vjen si nevojë e kahershme dhe e natyrshme, si kërkесë e shtruar, sidomos gjatë viteve të fundit nga përfaqësues të organizatave qeveritare, organizatave joqeveritare, përfaqësueseve të partive politike dhe të shoqërisë civile në përgjithësi. Pra, është kërkесë e përbashkët e jona që edhe Kosova të ketë ligjin për barazi gjinore.

Pasi që jam anëtare e Komisionit për barazi gjinore, dua të theksoj se para se të përpilohet Projektligji për barazi gjinore janë kontaktuar

përfaqësues të institucioneve dhe të organizatave qeveritare, vendore dhe ndërkombejtare, janë kontaktuar përfaqësues të organizatave joqeveritare, vendore dhe ndërkombejtare – ata që në prioritet në punën e tyre kanë çështjen e barazisë gjinore. Njëherit janë konsultuar edhe disa ligje për barazi gjinore të disa shteteve të regjionit dhe më gjerë.

Me qëllimin dhe në interes të asaj që ky Projektligj të jetë më leht i zbatueshëm në praktikë, ne këtu paraqesim vërejtjet tona.

Vërejtjet tona kanë të bëjnë me nenin 3, veçmas me nenin 3.2 dhe 3.5; nenin 6; 16.13, si dhe reflektimet që kanë këto nene në nenet tjera, si në nenin 10, 11 dhe 17.

Mendojmë se neni 3 imponon diskutim, ngase konsiderojmë se çdo çështje e përcaktuar me çelës është e dëmshme dhe s'është demokratike. Barazia gjinore nuk kuption përqindje por trajtim të barabartë me ligj. Paragrafi i këtij nenim pra 2 i nenit 3 ... Në lidhje pra me nenin 3.2 konsiderojmë se pjesëmarria e femrave nuk duhet të përcaktohet me shifra, por pjesëmarria e tyre duhet të jetë në përputhje me aftësitë e tyre. Garantimi 40% mund të jetë në situata të ndryshme pengesë për cilësi.

Njësoj mendojmë edhe për reflektime që ka ky nen në nenin 10 dhe 11, si dhe neni 17 ku parashihen masat ndëshkuese për të gjithë ata që nuk do të zbatojnë përbushjen e kësaj përqindjeje prej 40%-shit pra. Ne jemi dhe kërkojmë barazi më të kënaqshme gjinore, por mendojmë se kjo do të arrihet me një proces të gjatë dhe të vazhdueshëm. Do të duhej që kjo të arrihet me masa të tjera, ndërsa po të pranoheshin këto nene pa asnje ndryshim, atëherë me miratimin e këtij ligji do të duhej të fillonte menjëherë zbatimi i masave ndëshkuese.

Ne neni 3.5, mendojmë se dhënia e çmimeve dhe shpërblimeve publike nuk mund të vendoset në bazë të gjinisë por këto shpërblime do të duhej të përcaktohen në bazë të meritës.

Neni 6, ku flitet për avokatin ose avokaten për barazi gjinore, mendojmë se atij ose asaj i jipen më shum kompetenca se edhe vetë avokatit të popullit.

Neni 16.13, ku thuhet “se nuk lejohet heqja dorë nga e drejta për trashigimi dhe se trashigimtari e trashigimtarja mund të heqin dorë nga e drejta e trashigimisë pas afatit pesëvjeçar nga dita e ndarjes së trashigimisë”. Ne mendojmë se me këtë nen bëhet kufizimi i vullnetit të liri të individit dhe me këtë bëhet shkelja e të drejtave të njeriut. Qëllimi i këtij neni do të duhej të arrihej me masa të tjera e jo në formë të imponuar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në parim, mbështet Projektligjin për barazi gjinore dhe kërkon një rishikim të gjithanshëm dhe një riformulim të shum zgjidhjeve që ofron ky Projekjtligj. Ne kërkojmë që ky Projektligj të përcillet në procedurë të mëtejme dhe ne do të ofrojmë kontributin tonë në procesin e amendamentimit. Ju falemnderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT:**

Ju falemnderit. Zoti Ramush Haradinaj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

### **RAMUSH HARADINAJ:**

Më lejoni të them se kemi ngjashmëri nga prezentimi i parë që bëri zoti Hamiti. Edhe ne në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës në parim mbështesim këtë ligj. Unë kam dal të jap një shqetësim timin, por mos u friksoni shum. Ka të bëjë me shpërputhjen, më mundësinë në zbatim. Pra, ligji duket synues, mirëpo mendoj se nuk e ka pikënisjen. Andaj, dëshiroj që hartuesi ta marrë në konsideratë këtë shpërputhje. Pra, nëse ne me të vërtetë synojmë një ligj të zbatueshëm në realitetin dhe natyrshëm edhe të jetë synues, mendoj se duhet seriozisht të kujdesemi që të arrijë në një realitet të tillë. Por po ashtu e them se është një përparim i madh dhe mendoj se është një rrëthanë e re e cila rregullon shumëka që në një mënyrë apo në tjetër ka qenë e parregulluar.

Pra, që të jam i qart, mendoj se pikërisht për hirë të efektshmërisë së ligjit dhe për hirë të asaj që ky ligj të jetë i zbatueshëm dhe funksional,

mendoj se ne duhet, një shpërputhje që ekziston, ta kemi parasysh dhe ta eliminojmë pra në trajtimin e mëtutjeshëm të ligjit. Ju falemnderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT:**

Ju falemnderit. Remzije Nimani, le të bëhet gati Berat Luzha.

### **REMZIJE NIMANI:**

I nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe të rrespektuar deputetë,

Duke u nisur nga nevoja për ushtrimin dhe funksionimin e organeve qeverisëse që nga pushteti lokal e gjer tek ai shtetëror, mendoj se është bërë një punë mjaft e mirë nga grupi i ekspertëve, i kryesuar nga kryetarja e Komisionit për barazi gjinore zonja Melihate Tërmkolli. Kanë meritë të mëdha për përpilimin e këtij Projektligji, i cili për herë të parë në historinë e Kosovës i qaset një hartimi të këtillë që përfshinë të gjitha sferat e jetës në një shoqëri në të cilën çdoditë e më shum inkorporohen normat dhe standartet demokratike.

Kontribut të madh për hartimin e Projektligjit për barazi gjinore ka dhënë Komisioni funksional, i cili punoi me përkushtim. Jemi përpjekur maksimalisht dhe shpresoj se kjo përpjekje jona do të vlerësohet realisht nga ju deputetë të nderuar dhe nga opinioni.

Mendoj se në këtë Projektligj me të vërtetë është përfillë barazia gjinore, ku në asnjë nen nuk diktohet animi i njërsës gjini. Në bazë të kësaj besoj se në të ardhmen femra kosovare do të ketë çdoditë e më shum kurajo dhe vetëbesim që të kyçet në jetën shoqërore e politike, pa hezitim se do të jetë e diskriminuar në baza gjinore. Sepse, sipas këtij Projektligji, janë paraparë edhe sanksione në rast të shkeljes së rregullave ligjore e në baza gjinore.

Nuk them se në hartimin e këtij Projektligji kemi bërë një punë të përkryer, por jemi të gatshëm që së ishte pranojmë kritika dhe

sygjerime nga deputetët dhe nga opinioni, sepse do ta plotësojnë dhe do t'ia japid formën e duhur duke plotësuar edhe me amendamente të tjera.

Unë propozoj që ky Projektligj të pranohet në parim. Ju falemnderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT:**

Ju falemnderit. Zoti Berat Luzha. Le të bëhet gati Mehdi Bardhi.

### **BERAT LUZHA:**

Gjithësesi është për t'u përshëndetur miratimi i një ligji të tillë, që ka të bëjë me barazinë gjinore, por mendoj përsëri edhe në ligj nuk është arritur qëllimi për shkak se parashihet vetëm 40%. Unë propozoj që të jetë 50% barazia ose të mos jetë fare, për shkak se me numra nuk realizohet barazia gjinore.

Këtu është dispozita që çdo organizatë politike, duke përfshirë edhe partitë, madje edhe organizatat joqeveritare, edhe mediat duhet t'i kenë si kusht - për t'u regjistruar... duhet t'i kenë 40% të anëtarësisë, që mendoj është një absurd në vete.

Mendoj se mjafton zyra për barazi gjinore që është në nivele komunale dhe në nivelin qendror dhe nuk ka nevojë për avokat për barazi gjinore dhe nuk ka nevojë për një këshill koordinues ndërministror, çfarë është propozuar këtu, për shkak se janë të panevojshme dhe nëse funksionojnë mirë zyrat për barazi gjinore janë të mjaftueshme për ta udhëheqë një lëndë kësisoj çfarë e parashev ligji.

Është një absurd tjetër ku thuhet, në nenin 16.13 "nuk lejohet heqja dorë nga e drejta për trashigimi". Askujt nuk mund t'i jepësh me zor, mund t'i marrësh me zor, por jo t'i jepësh me zor diçka. Prandaj, duhet shumëshka të hiqet dhe të rregullohet ky ligj. Ju falemnderit.

**Prej këtu, Seancën plenare e kryeson bashkëkryesuesisi Bajram Kosumi.**

**KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit Berat. Radhën përfjalë e ka Mehdi Bardhi, le të përgatitet Fadil Kryeziu.

**MEHDI BARDHI:**

E nderaura Kryesi, të nderauar deputetë, zonja dhe zotërinj,

Ju e dini që ligjet çdoherë diçka kufizojnë diçka japin përparësi. Komisioni për barazi gjinore i Parlamentit të Kosovës ka përgatitur Projektligjin për barazi gjinore, të cilin e paraqet para nesh përmiratim. Ky Projektligj është në vazhdën e proceseve demokratike dhe institucionale të Kosovës. Është zbatim i modeleve të reja të komunikimit dhe edukimit, i cili çon drejt avancimit të barazisë gjinore ku gratë dhe burrat të gjelqjnë status të barabartë, jo vetëm me ligj por edhe realisht, sepse barazia gjinore ka të bëjë me krijimin e kushteve të barabarta, ato kushte që plotësojnë të gjitha të drejtat e tyre për t'iu krijuar kushte për pjesëmarrje aktive më të madhe në organet e vendimmarrjes.

Në këtë Projektligj apo ligji i nesërm, nuk bëhet fjalë për përblysje të roleve që gratë të bëhen burra ose anasjelltas, e as që është nisë nga logjika e numrave statistikor se ma shum ka burra apo gra dhe barazia apo e drejta të ndahet në përqindje, të cilat nuk mund edhe të injorohen sepse 55% të punëve në botë i bëjnë gratë, pa llogaritur punën pa para në shtëpi, e cila nuk konvertohen në ekonomi. Por ky Projektligj i cili, me vërejtjet dhe sygjerimet tuaja, dëshiroj që të aprovohet në parim. Sepse, është produkt i një zhvillimi shoqëror e politik dhe i një zhvillimi demokratik i shoqërisë sonë kosovare në kushtet e tanishme transitore dhe të përkohshme; është produkt i punës së këtij Parlamenti, e në veçanti i punës së Komisionit për barazi gjinore të këtij Kuvendi dhe njëherit është dëshmi e vitalitetit dhe aftësisë së gruas shqiptare për të

qenë e barabartë me burrin, e cila meriton një vlerësim dhe rrespekt më të madh në shoqëri. Gruaja nuk kërkon të vlerësohet më shum se sa meriton, vetëmse i takon gjinisë së bukur, por të vlerësohet në bazë të përvojës, njohurive, aftësive profesionale dhe vlerave që bartë individi burr apo grua qofshin ata.

I njohur është roli i gruas shqiptare gjatë historisë së përvuajtur në mbrojtje të atdheut e veçanërisht në luftën e fundit me Serbinë nazifashiste, e cila ishte e barabartë me burrin edhe në front, edhe në llogoret, si thotë populli. Përse mos ta sanksionojmë edhe me ligj demokratik barazinë gjinore ku do t'i mundësohej gruas pjesëmarrja në të gjitha lëmitë e jetës dhe t'i jipet mundësia gruas për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit, në zhvillimin politik e social dhe demokratik të Kosovës.

Propozoj që të aprovohet në parim ky Projektligj, i cili nuk them se është i përkryer, i cili pas leximit të parë mund t'i herren dy apo tri nene, aty ku bëhet fjalë për avokatin apo kuotën e dëshiruar 40% të pjesëmarrjes së saj në institucionet, por edhe këto nene, për të cilat u debatua mjaft edhe në Komisionin për barazi gjinore si sponzorizues, që kanë për qëllim apo synojnë që të arrihet kjo shkallë e barazisë gjinore. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit deputeti Bardhi. Fjalën e ka Fadil Kryeziu, le të përgatitet zonja Nekibe Kelmendi. Ju kisha latur që të rrespektoni një kohë më të shkurtër të diskutimit.

### **FADIL KRYEZIU:**

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë,

Thënë të drejtën, me daljen time në këtë foltore ndoshta, në njëfarë mënyre po rrezikoj në planin politik si deputet, por pak befasohem, po them kushtimisht, me gjininë mashkullore të cilët në njëfarë mënyre e

mirëpresin këtë ligj, por që në fakt nuk janë shum të vetëdijshëm për të drejtat e tyre që cungohen gjithashtu, aq më tepër vetë gjinia femrore që me këtë ligj në njëfarë mënyre cungon të drejtat e saja. Pse? Sepse, unë shtroj pyetjen – çka në fakt për ato të drejta që iu takojnë e që nuk janë të prëfshira në këtë ligj? Çka prapa rreshtave të këtij ligji?

Dhe, së fundi, jo së fundi se vec ia nisa, por do të shfrytëzoj kohën vetëm dyminutëshe... Ligji, sipas mendimit tim duket se përligjë pabarazinë gjinore. Unë nuk do të pajtohem me këtë fakt sepse asnjë ligj që ky Parlament ka aprovuar deri më tash nuk precizohet se ka të drejtë vetëm mashkulli ose ka të drejtë vetëm femra.

Kuotat që u theksuan këtu janë një paradoks që aplikohet vetëm tek ne në Kosovë. Ju lutem, urdhëroni shifni parlamentet e shteteve të ndyshme, madje shteteve shumdemokratike botërore dhe shihni përfaqësimin e femrave. Unë do të thosha që të jetë 70... 90% të femrave në Parlamentin e Kosovës. Femra duhet të jetë ajo, sikurse edhe mashkulli, që të angazhohet për realizimin e të drejtave të tyre dhe do t'i sygjeroja propozuesve, pra në këtë rast Komisionit, që të punojnë më shum në ndryshimin e mentalitetit të njerëzve, e unë besoj se në Kosovë kjo ecën fuqishëm para.

Unë nuk kam faj edhe për një çështje kur një shkencëtar françez thekson, përveç tjerash: femra është më e fortë se mashkulli. Dhe, në fakt, kjo është shum e vërtetë. Por një sentencë, që do të dëshiroja ta përfundoj këtë që të them se të drejtat e mashkujve në shum raste edhe rrezikohen dhe do të doja që ndoshta të nisim edhe procedurën e formimit të ndonjë OJQ-je për mbrojtjen e atyre drejtave por thotë kështu një sentezë, nëse mund ta parafrazoj në mënyrë origjinale: mashkulli sundon botën por në fakt gruaja sundon mashkullin. Ju falemnderit.

## **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit zoti Fadil Kryeziu. Zonja Nekibe Kelmendi e ka fjalën. Shpresoj diskutimi i fundit.

## **NEKIBE KELMENDI:**

I nderuari kryesues i Seancës, të nderuar kolegë deputetë,

S’ë pata ndërmend të dal të diskutoj, mirëpo unë do t’i qasem nga një vështrim krejt tjetër diskutimit tim lidhur me ligjin për barazinë gjjinore.

Nga një shfletim shpejt e shpejt të këtij ligji, pash se këtu janë përfshirë disa fusha. Kujtoj se ky ligj ka synuar ta bëjë një kodifikim të materieve që merren me çështjet e të drejtave të grave, megjithatë nuk ia ka dalë. Ose, më shum, të them, është bërë duplikimi... Dhe, në të ardhmen kur të amendamentohet ky ligj duhet të kemi kujdes që disa çështje të mos futen në këtë ligj. Kur them këtë, kam parasysh çështjen e trashigimisë, apo të ndarjes së pasurisë së përbashkët. Ajo është një çështje që është e rregulluar me një ligj krejt tjetër – me ligjin mbi trashigiminë, me ligjin mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare. Ose, kur është fjala për nenin 16 pika 15 dhe 16, e cila e trajton çështjen e ndërprerjes së shtatzënisë apo abortit. Këto çështje janë të rregulluara me ligjin për mbrojtjen shëndetësore dhe kujtoj se disa sende duhet të hiqen, edhe këto duhet të hiqen krejtësisht nga ky ligj. Prandaj, do t’i sygjeroja edhe Komisionit, por edhe atyre që inkuadrohen për ta amendamentuar këtë ligj të kenë parasysh dhe të mos përsëriten gjërat dhe të mos përzihen. Ne nuk mund ta bëjmë një ligj të kodifikuar për barazinë gjinore, sepse pothuaj në të gjitha ligjet preket edhe e drejta e gruas dhe mbrojtja e saj në shoqërinë kosovare. Ndoshta do të ishte një gjë që do të mundte t’i barazonte femrat me meshkujt – një formulim në aktin më të lartë kushtetues të Kosovës, ku do të thuhej: meshkujt dhe femrat janë të barabarta para ligjit, dhe atëherë nuk do të kishim nevojë për një ligj për barazi gjinore. Ju falemnderit.

## **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit, zonja Kelmendi. E ka kërkuar fjalën edhe deputeti Ismajl Kurteshi.

### **ISMAJL KURTESHI:**

Sa i përket këtij ligji, unë konsideroj se ligji është..., kur është hartuar është udhëhequr me logjikën se pjesëmarrja e barabartë garanton edhe barazi gjinore. Unë konsideroj se ndonjëherë pjesëmarrja e barabart mund ta diskriminojë njërën nga gjinitë për shkak të natyrës së punëve të ndryshme dhe mendoj se mundësia për pjesëmarrje të barabartë dhe trajtimi i barabart i gjinive është forma më e drejtë e rrespektimit të barazive të gjinive dhe mendoj se formulimi apo logjikë për pjesëmarrje të barabartë do të duhej të hiqet nga ligji dhe ligji të lirohet nga kjo logjikë. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit deputeti Ismajl Kurtoshi. Ju kisha lutur, duhet të paraqiteni te shërbimi për diskutim. Qe dy herë them është diskutuesi i fundit. Urdhëroni zoti deputet, pastaj Haxhi Zylfi Merxha. Nëse ka ndokush, le të paraqitet tani.

### **MILOVAN JOVANOVIĆ:**

Poštovani predsedavajući, poštovane kolege,

Vratili smo se ponovo na plenarnu sednicu Skupštine Kosova i metohije da izrazimo svoj protest zbog ponašanja gospodina predsednika Nexhata Dacija....

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

I nderuari deputet, ndaleni atë tiskutim dhe mos dilni jashtë temës e cila është në shqyrtim.

**MILOVAN JOVANOVIĆ:**

... Pa da vam kažem, gospodine predsedavajući. Ne da govorimo o ravnopravnosti polova već o neravnopravnosti poslanika i u izvesnim elementima diskriminacije. Mi imamo mandat svog naroda da pred ovim Parlamentom kažemo ono što nas ...

**KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Jo, jo. Ka kaluar ajo p ikë. Jemi në pikën e dytë. Zoti Ivanoviq, është shqyrtimi i parë i Projektligjit.... Ju lutem i nderuar deputet...

**MILOVAN JOVANOVIĆ:**

... Da vam kažem ovde je izneta jedna elementarna neistina da se predsednik konsultovao sa svim parlamentarnim grupama, a nije se konsultovao.

(Ndërprerje toni)

**KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju lutem qetësi. Nuk ka rikthim në pikën e parë të rendit të ditës, nuk ka rikthim. Deputet Ivanoviq, nuk ka rikthim. Nëse keni për pikën e dytë, urdhëroni, nëse jo – ju lutem shkoni në vend. Ju falemnderit.

E ka fjalën zoti haxhi Zylfi. Ju lutem për qetësi në sallë.

## **HAXHI ZYLFI MERXHA:**

Zotri kryesues i nderuar, zotri ministra tē nderuar, zoj – zotri tē nderuar deputetë,

Sot kam dal para mikrofonit se duhet ta dini që nē Evropë na jemi një Parlament ma i ri i cili asnjë parlament nē Evropë edhe nē botë s'ka numër mjaftueshëm sikur na që kemi 33% femra nē Parlament, 67% mashkuj. Mirëpo, tashti kisha propozu tē kundërtën – 67% net jenë femra – 33% mashqi. E përkrasi ligjin, Komisionin që e pruni pér barazi gjinore edhe e përshëndesi komisionin nē krye me zojen Melihate. Deri sot ky ligj ma s'paku ka pasë gabime, vetëm qëky ligj, edhe ato gabime që i përmirësuem, unë isha pér ato nē parim menjëheri ta quesim net'pranohet. Unë jam pér to, se vallahi, - ligj ma t'mirë s'e kam pa. Falemnderit.

## **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Tē falemnderit deputet Haxhi Zylfa. Ju lutem ta quesim nē votim nē parim Projektligjin pér barazi gjinore.

Kush është pér, nē parim? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një është kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Nuk abstenon.

Atëherë, më lejoni tē konstatoj se Projektligji pér barazi gjinore 2003/29 nē parim u miratua.

Dhe tash ngarkohen komisionet: Komisioni pér gjuqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, si komision funksional pér shqyrtimin nē vazhdim tē këtij ligji dhe Komisioni pér buxhet dhe Komisioni pér barazi gjinore. Që tē tri këto komisione, nē rolin e komisioneve funksionale, kanë obligim që brenda 3 javësh tē shqyrtojnë vërejtjet që janë dhënë këtu dhe amendamentet që do tē vijnë qoftë prej deputetëve apo grupeve

parlamentare dhe ta sjellin Projektligjin në shqyrtim të dytë këtu. Ju falemnderit.

**Votimi – Glasanje – Voted:**

- Për – Za – For ..... Shumica – Vecina – Majority.....
- Kundër – Protiv – Against ..... 01.....
- Abstenime – Uzdrzanih – Abstained....00.....

Kalojmë apo rikthehami në pikën 3:

- Projektligji për kadastër numër 2003/30.

Më lejoni t'i them konstatimet hyrëse.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 8 tetor 2003 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform rregullës 31. pika 1, e tjera...

Debati i sotëm është debat në parim, do të thotë shqyrtohet në parim dhe vërejtjet parimore do t'u referohen përsëri komisioneve.

Ftoj ministrin, zotin Jakup Krasniqi, që si propozues i Projektligjit ta marrë fjalën.

**JAKUP KRASNIQI:**

I nderuari kryesues, zonja dhe zotërinj deputetë,

Sot paraqesim një Projektligj të ri. Mendoj se është mjaft i rëndësishëm për periudhën në të cilën po kalon Kosova.

Duke marrë për bazë mungesën e legjislacionit në marrëdhëniet pronësore, Grupi punues në Ministrinë e Shërbimeve Publike, i përbërë prej ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar, hartoï këtë Projektligj.

Nxjerrja e ligjit mbi kadastrën është i një rëndësie të jashtëzakonshme për Kosovën, pasi që qytetarëve në marrëdhënie të sotme pronësore, me ligjin e aplikueshëm deri më tanë, nuk iu janë ofruar shërbime kadastrale bashkëkohore. Ky ligj do t'i plotësojë zbratzësitë ligjore në këtë fushë, pastaj matjet dhe punët tjera lidhur me të. Gjithashtu ky ligj zbaton standardet bashkëkohore në lëminë e kadastrit duke eliminuar ligjet e aplikueshme të cilat, në nivelin e tanishëm të zhvillimit të kadastrit dhe marrëdhënieve pronësore, janë të pazbatueshme dhe të tejkalaura në Kosovë. Ndryshimet në mes të këtij ligji dhe ligjit të aplikuar mbi kadastrin deri më tanë janë: matja, jo vetëm e parcelave të tokës por edhe ndërtesat, pjesët e ndërtesave si dhe përçojat. Është fjala për linjat e tensionit të lartë të rrymës, gypat e ujësjellësit, kanalizimit, gypat për transportimin e gasit, të naftës e tjera.

Agjencia Kadastrale e Kosovës do të jetë përgjegjëse mbi kadastrin dhe procedurat kadastrale. Është ofruar mundësia që edhe kompanitë private gjeodete të kryejnë veprimit kadastrale.

Matjet dhe përgatitjet tjera lidhur me formën e pronës: Është krijuar një sistem më formal për krijimin e pronës përkatësisht për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridikë; Është formalizuar procedura për përcaktimin e kufinjve kadastral, procedura e regjistrimit dhe janë qartësuar me përgjegjësi dhe afate kohore për zyrat kommunale kadastrale; Është qartësuar procedura për aplikimin kundër vendimeve të AKK dhe zyrave komunale të kadastrave.

Me këtë ligj do të garantohet trajtimi i barabart i të gjitha subjekteve që do të merren me punën e kadastrit dhe matjet kadastrale në Kosovë, siç janë: Agjencia Kadastrale e Kosovës, si autoritet qendror kadastral; zyrat kommunale si organe të nivelit lokal; kompanitë e licencuara gjeodete; gjeodetë të licencuar, si dhe kompanitë tjera.

Ligji gjithashtu siguron interesat publike dhe ato private, si dhe siguron përmirësimin e cilësisë së kryerjes së shërbimeve kadastrale për institucionet qeveritare dhe qytetarët.

Roli i ligjit mbi kadastrin është i shumëfisht. Ky ligj përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë për të gjitha subjektet që do të mirren me punën e kadastrit: Agjencia Kadastrale e Kosovës; zyrat kommunale të kadastrit; kompanitë e licencuara; gjeodetët e licencuar dhe subjektet tjera.

Ligji ka rëndësi edhe përvèç veprimitarisë së kadastrit edhe në themelimin e regjistrat të së drejtave mbi pronën e paluajtshme dhe regjistrimin e tyre.

Hartimi i këtij Projektligji është i bazuar në përvojat dhe standarde bashkëkohore në lëmin e kadastrit. Këto përvoja janë marrë nga vendet të cilat përafërsisht iu përgjigjen kushteve të Kosovës nga vendet perëndimore; përvojat e ekspertëve ndërkombëtar; përvojat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Duke marrë për bazë rëndësinë e këtij ligji, i cili është bazë për zhvillimin e kadastrave të Kosovës, i propozoj Kuvendit që ta miratojë. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit ministër Krasniqi. Hapim debatin në parim për Projektligjin për kadastrin.

Në emër të komisioneve, kanë të drejtën të parët, pastaj grupet parlamentare. Fjalën e ka zonja Nekibe Kelmendi, në emër të Komisionit dhe Grupit Parlamentar të LDK. Le të përgatitet Xhelal Canziba, në emër të Grupit Parlamentar të PDK.

### **NEKIBE KELMENDI:**

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë,

Ndonëse Komisioni për shërbime publike nuk ka marrë në shqyrtim këtë ligj, megjithatë unë do të jap mendimin tim si kryetare e këtij Komisioni,

pa ua mohuar të drejtën anëtarëve të tjerë të Komisionit që të shfaqin mospajtim me mendimin tim.

Si kryetare e Komisionit për shërbime publike kujtoj se rëndësia e nxjerrjes së këtij ligji është s'hum e madhe d'he mendoj se Qeveria ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë kur i është qasur hartimit të Projektligjit për kadastrin, sepse rregullon një materie që është tejet e ndieshme dhe një materie që është pothuaj burim i të këqiave në Kosovë. Kur e them – burim i të këqiave, dua t'ju kujtoj se është fjala për pronën dhe një filozof i madh ka thënë se: “Dreqi asgjë më të keqe s'ka krijuar se atëherë kur ka rrëthuar një copë tokë njeriu dhe ka thënë se kjo është e imja”. Pastaj prej aty kanë filluar të dalin edhe të gjitha të këqiat.

Kujtoj se ky ligj e ka rolin e vet jashtëzakonisht të rëndësishëm edhe në parandalimin..., përveç në rregullimin e materies me të cilën merret, por edhe në parandalimin e shum vrasjeve dhe të mosmarrëveshjeve rrëth pronës, sepse me këtë ligj secila pronë e fiton legjitimacionin e vet dhe me atë njeriu edhe paraqitet si titullar i të drejtës së pronës.

Si Grup Parlamentar do të diskutoj për këtë ligj gjithashtu se është mjaft i rëndësishëm. Mendoj se me këtë ligj po bëhet njëherë e përgjithmonë një ndërprerje e një sistemi të tërë çfarë ka ekzistuar me shekuj në Kosovë. Domethënë, ky ligj e përjashton tërësisht sistemin e tapive që ka ekzistuar në Kosovë dhe në mënyrë shum bashkëkohore e trajton çështjen e regjistrimit. Do të dëshiroja të ekzistojë edhe një libër i regjistrat, jo vetëm kadastro por libra tokësor në kuadër të kadastrit dhe ndoshta do të kishte vend edhe një këtë ligj që të futen edhe ato librat tokësore dhe të janë pjesë përbërëse e këtij ligji, në mënyrë që të dihet edhe historiat i pronës. Sepse, në sistemin juridik të Austro-Hungarisë ata e kanë përsosur çështjen e historiatit të pronës dhe te ta dihet edhe pas 500 vjetëve kush ka qenë pronar i ndonjë paluetshmërie.

Do të thoja edhe atë se ky ligj është shum bashkëkohor dhe mendoj se m'i përngjanë Ligjit të Finlandës që e rregullon këtë materie, e të cilët vërtetë duhet të mburren me një sistem të kadastrit çfarë e kanë të rregulluar.

Kam vetëm një apo dy vërejtje, që ndoshta do të jenë edhe çështje të cilat duhet të shtrohen gjatë amendamentimit të këtij ligji, e këto janë: Neni 4, ku bëhet fjalë për kompanitë gjeodete të liçencuara, ose ndryshe, të them – për kompanitë private. Kompanitë private kujtoj se duhet të kenë në fushëveprim të vetin vetëm matjen e tokave, dhe vetëm caktimin e kufinjve midis tokave të titullarëve të ndryshëm të pronës, por të mos kenë kompetenca sa i përket ndryshimeve apo bartjes së pronës nga një titullar në tjetrin. Këto duhet ta bëjë agjencia shtetërore e kadastrit, është lëmi jashtëzakonisht e ndieshme. M'u për këtë arsy, kujtoj se në nenin 4 duhet edhe të parashihen kushtet të cilat e mundësojnë apo ia mundësojnë kompanisë private për të konkuruar për të ushtruar, pra kompania private, në mënyrë private liçencimin. Ashtu njësoj sikur që do të ishte ligji për noterinë që kryen një pjesë shum të madhe të punës së gjykatave dhe të komunave, ashtu do të kishte edhe kompania private, në fushëveprimin e vet, një veprimitari që do të ndihmonte apo do ta shkarkonte shum, bile për çështje teknike, agjencinë e kadastrit.

Nuk jam e mendimit që me urdhëresë administrative të parashihen kushtet e liçencimit, por me këtë ligj.

Nga ana tjetër, është marrë me nenin 18, 19, 20 ose thënë shkurt, me pjesën e 5-të të këtij ligji, ku bëhet fjalë për përcaktimin e kufinjve dhe të rregullimit të atyre kufinjve. Kjo komplet është marrë prej kompetencave të gjykatave që veprojnë në bazë të Ligjit mbi procedurën jashtëkontestimore. Nëse kjo duhet të mbetet si formulim me këtë ligj, e unë kujtoj se nuk duhet, sepse nuk kemi kuadro, tash për tash, të cilat do të mund t'a zbatojnë në jetë pjesën e pestë, por nëse mbetet kështu atëherë duhet diku të thuhet – në dispozitat përfundimtare se “një pjesë e ligjit për procedurën jashtëkontestimore dhe një pjesë e rregulloreve të gjykatave që trajtojnë këtë materie, të shfuqizohen”.

Më konkretisht, unë mund ta jap edhe kontributin tim personal, por prapë po i kthehem asaj: Kujtoj se pjesa e 5-të është heret të parashihet me këtë ligj. Le t'i lëhet gjykatave deri në organizimin e punës së tyre, e njëkohësisht deri në atë periudhë edhe agjencitë kadastrale do të aftësohen të veprojnë në këtë mënyrë. Vërtetë është mënyrë e veprimit jashtëzakonisht bashkëkohore që duhet t'ia ketë lakmi secili shtet,

mirëpo rezervat e mia kanë të bëjnë vetëm me mungesën e infrastrukturës së kuadrove.

Përndryshe, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, shpreh mendimin e tërë Grupit se ky ligj në parim përkrahet dhe propozojmë që të hyjë në procedurë për aprovimin e tij. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit zonja Nekibe. Fjalën e ka zoti Xhelal Canziba, në emër të Grupit Parlamentar të PDK. Le të përgatitet zoti Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK.

### **XHELAL CENZIBA:**

I nderuar kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Kosova ka nevojë për nxjerrjen e një ligji për kadastër, sepse Kosovës i mungon legjislativin i përshtatshëm, i cili i referohet lëmisë së kadastrit. Me këtë ligj eliminohen zbratzësitë ligjore në çështjet që kanë të bëjnë me kadastrin dhe punët tjera që kanë të bëjnë me të. Po ashtu, ky ligj eliminon edhe ligjet e aplikueshme që tanë, me këtë nivel të zhvillimit të kadastrit, janë të pazbatueshme.

Ndryshimet në krahasim me ligjin e aplikueshëm janë:

- Me kadastër, përveç parcelave të tokës, do të regjistrohen edhe ndërtesat, pjesë të ndërtesave si dhe përçojat;
- Agjencia Kadastrale e Kosovës do të ketë përgjegjësinë mbi kadastrin dhe procedurat kadastrale;
- Janë hapur mundësitë për formimin e kompanive gjeodete private për kryerjen e veprimtarisë kadastrale;
- Është krijuar një sistem më i lehtë për formimin e pronës;

- Është formalizuar procedura për përcaktimin e kufinjve;
- Procedura e regjistrimit është qartesuar me përgjegjësi dhe afate
- kohore për zyrat kadastrale komunale;
- Është qartesuar procedura për apelim kundër vendimeve të Agjencionit Kadastral të Kosovës dhe zyrave kadastrale komunale;
- Me këtë ligj do të garantohet trajtimi i barabart për të gjithë subjektet që do të merren me punët e kadastrit dhe të matjeve kadastrale në Kosovë, siç janë: Agjencia Kadastrale e Kosovës, si autoritet qendror kadastral; zyret komunale si organe në nivel lokal; kompanitë e licencuara gjeodete; gjeodetë të licencuar dhe subjekte tjera;
- Ky ligj siguron aplikimin dhe adaptimin e ndryshimeve të cilat kanë ndodhur në Kosovë për periudhën e pasluftës;
- Është shfrytëzuar ndihma e ekspertëve ndërkombëtar, nga shtete të caktuara në fushën e kadastrit, si nga aspekti teknik, ashtu edhe në atë normativ;
- Ligji po ashtu siguron interesat publike dhe private;
- Ligji mbi kadastrin ka rol të shumfishtë. Roli kryesor është në përcaktimin e kompetencave dhe të përgjegjësive për të gjithë subjektet që do të meren me punët e kadastrit: Ministria e Shërbimeve Publike; Agjencia Kadastrale e Kosovës; zyrat komunale kadastrale; kompanitë e licencuara; gjeodetë të licencuar dhe subjektë tjerë;
- Roli tjetër i ligjit konsiston në rregullimin e veprimtarisë në çështjet që kanë të bëjnë me kadastrin, si dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar;
- Ligji ka një rëndësi mjaft të madhe edhe në themelimin e regjistrimit të drejtave mbi pronën e paluejtshme dhe për regjistrimin e tyre.

Projektligji mbi kadastrin është i bazuar në përvojat dhe standarde bashkëkohore nga lëmia e kadastrit. Përvojat janë marrë nga vendet që kanë një kadastër të zhvilluar dhe që kanë pasë një bazë përafërsisht si Kosova; nga përvoja e ekspertëve ndërkombëtar, si dhe nga përvoja e Agjencionit Kadastral të Kosovës, që së bashku me ndihmën e shum partnerëve të jashtëm është krijuar me punë pas luftës, e në veçanti në aplikimin e standardeve bashkëkohore nga lëmia e kadastrit në rindërtimin e kadastrit në Kosovë.

Domosdoshmëria për këtë Projektligj mbështetet në nevojën që çështjet nga lëmia e kadastrit të futen në korniza ligjore. Projektligji arrin të eliminojë zbarztësitë që momentalisht e përcjellin kadastrin e Kosovës.

Dispozitat e përgjithshme, qëllimi, përkufizimet, autoritetet dhe përgjegjësitë, kompanitë gjeodete të liçencuara;

Pjesa e dytë: Kadastro – dispozitat themelore për kadastrin; njësitë në kadastër; regjistrimi i parcelave të tokës; regjistrimi i ndërtesave; regjistrimi i pjesëve të ndërtesave; shlyerja e një ndërtese apo pjese të ndërtesës nga regjistri; regjistrimi dhe përbajtja e pjesës së pérçojave në kadastër.

Pjesa e tretë: matjet kadastrale;

Pjesa e katërtë: Formimi i pronës. Kushtet për formimin e pronës; procedura e formimit të pronës. Nëndarja dhe shkrirja e ndërtesës apo të një pjese të ndërtesës;

Pjesa e pestë: përcaktimi i kufinjve dhe rregullimi i tyre; parimet themelore për përcaktimin e kufinjve; procedurat për përcaktimin e kufinjve, rregullimi i kufirit.

Pjesa e gjashtë: rishqyrtimi dhe shqyrtimi i vendimeve të zyrave kadastrale komunale.

Pjesa e shtatë: korrigjimi i regjistrat; shpallja e të dhënavë publike.

Pjesa e tetë: çertifikatat dhe të dhënrat tjera për përdorim zyrtar; ndërveprimi me kompjuter; financimi: – financimi i kadastrit tokësor;

Pjesa e dhetë d'ispozitat specifike: lejimi i qasjes; mbrojtja e shtenjafë kufitare; rindërtimi i formacioneve kadastrale.

Pjesa e njëmbëdhjetë: mbikëqyrja; inspektimi dhe masat. Këtu e kemi një vërejtje ku thotë “AKK është përgjegjëse për mbikëqyrjen e implementimit të ligjit mbi kadastrin. AKK mund të zgjedhë një zyrtar inspektor për të inspektuar zyrat komunale kadastrale; kompani të në lidhje me aktivitetet e tyre kadastrale”.

Unë mendoj se një inspektor nuk mund t'i kryejë këto, prandaj duhet me pasë një numër të caktuar të inspektorëve.

Dispozitat ndëshkuese; dispozitat kalimtare.

Edhe te dispozitat ndëshkuese, “personi juridik apo fizik do të dënohet me gjobë në vlerë prej 100 deri në 300 euro, nëse ai nuk do të lejojë hyrjen e personave të autorizuar në pronën e tij për aktivitetet e matjes apo detyrave zyrtare të caktuara në këtë ligj”. Ndërsa, “me shumën 300 deri 600 euro do të dënohet në gjobë, personi juridik apo fizik, i cili i zhvendosë, fshehë apo dëmton shenjat kufitare”. Mendoj është çmimi pak i lartë.

Përgëzoj ministrin e Shërbimeve Publike për këtë Projektligj të përgatitur mirë.

Grupi Parlamentar i PDK përkrahë në parim këtë Projektligj. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit Xhelal. Radhën e ka Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK, kurse le të përgatitet Fatmir Rexhepi. Ju kisha lutur që t'i përbaheni pak një kohe më të shkurtër dhe të mos dilni shum prej temës çfarë është në shqyrtim.

## **XHEVDET NEZIRAJ:**

I nderuari zoti kryesues, i nderuar zoti ministër, të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrahë këtë Projektligj, i cili rregullon një fushë mjaft me rëndësi në Kosovë dhe besoj, për të metat që ka ligji, grupet dhe komisionet, do ta kryejnë atë detyrë ashtu si iu ka hije dhe do të dalë një ligj me të vërtetë që do ta rregullojë një fushë mjaft me peshë dhe me rëndësi në Kosovë. Ju falemnderit.

## **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit, Xhevdet. Fatmir Rexhepi, le të përgatitet Ibush Jonuzi.

## **FATMIR REXHEPI:**

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë,

Ligji mbi kadastrin, projektpropozimi që nga kreu i parë deri në kreun e 14-të ka një përbajtje shum të mirë dhe të qartë për mundësinë që të implementohet në praktikë. Por, unë mendoj se e ka një zbraztësi. Për mendimin tim, mungon edhe një kapitull i veçantë i cili do ta kishte vendin brenda numrit 2 ose 3.

Meqenëse kemi të bëjmë me një institucion i cili mbikëqyrë, përcjell punën, organizon punën dhe i ka të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat, pra Agjacioni i Kadastrit të Kosovës, unë brenda këtij ligji shoh një zbraztësi, që mungon, do të thotë – sanksionimi brenda i këtij ligji mbi këtë agjpcion, si institucion i veçantë i cili do të mirret me këtë punë.

Dhe në pjesën e përgjithshme të këtij ligji është vendosë: “Ministria e Shërbimeve Publike – Agjacioni Kadastral i Kosovës” që është barabar. Mendoj se nuk shkojnë ato, prandaj duhet t’ia gjejnë vendin ata që mund ta ndërtojnë brendinë dhe strukturën e këtij Projektligji, do të

thotë, me organizimin dhe statusin e Agjencionit Kadastral të Kosovës: kush duhet të jetë propozuesi, si duhet të duket ai dhe kompetencat tjera që përcaktohen për agjencione, konform modeleve që kemi pasë në projektligjet tjera. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Fjalën e ka IBush Jonuzi.

### **IBUSH JONUZI:**

Zoti kryesues, deputetë të nderuar dhe ministra,

Së pari, fuqishëm mbështes diskutimin e zonjës Kelmendi, e cila, mendoj ka përfshirë në tërësi esencën e kësaj çështjeje.

Do të ndalem në disa çështje konkrete. Projektligji për kadastër ka disa mangësi, dhe atë nën:

1. Në Projektligj të hartuar, nuk figuron kush inicon programet afatshkurtëra, afatmesme, afatgjata dhe kush i menaxhon;
2. Nuk figuorn kush e mirëmban elaboratin dhe kush e arkivon;
3. Nuk ceket kush e kryen aerofotografimin e terrenit dhe kush e autorizon një veprim të tillë që është shum i rëndësishëm;
4. Nuk figuron që elaboratori kadastral nuk guxon të dalë nga zyret;
5. Në Projektligj nuk janë precizuar klasat dhe boniteti i tokave;
6. Nuk rrespektohet ligji i komasacionit;

7. Për çështjet ndoshta më delikate, figuron se ato do të rregullohen me udhëzime administrative, ku në këtë formë lë hapësirë për manipulime, e tha zonja Kelmendi shummirë.

Dhe, krejt për fund, ka mundësi që në fazën e amendamentimit të bëhet plotësimi dhe ndryshimi, në mënyrë që ligji i aprovuar të jetë i zbatueshëm në praktikë. Prandaj, në parim e mbështes. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit I bush. Nuk ka më diskutues të paraqitur.

E vë në votim Projektligjin për kadastrin numër 2003/30.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Një abstenim.

Ju falemnderit. Konstatoj se Projektligji për kadastrin, në parim është votuar d'he tash marrin përgjegjësinë Komisioni për shërbime publike, Komisioni për gjyqësi, legjislacion e kornizë kushtetuese dhe Komisioni për buxhet që ta shqyrtojnë në vijim Projektligjin dhe amendamentet e bëra nga deputetët dhe grupet tjera.

---

#### Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For ..... Shumica – Vecina – Majority.....
  - Kundër – Protiv – Against ..... 00.....
  - Abstenime – Uzdrzanih – Abstained..... 01.....
- 

Komisionet duhet brenda tri javësh t'i shqyrtojnë amendamentet dhe ta rikthejnë Projektligjin në shqyrtim të dytë .

Prandaj, po myllim edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës: - Propozimi i rendit të ditës për Seancën plenare më 30 tetor 2003, dhe atë:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër diskriminimit;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspektoratin sanitari, dhe
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pensionet e aftësisë së kufizuar.

Vetëm shefat e grupeve parlamentare ose në emër të tyre kanë të drejtë. Urdhëroni.

### **LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:**

Hvala gospodine Kosumi. U ime Poslaničke grupe Koalicije «Povratak» za sledeću sednicu ja predlažem jednu tačku dnevnog reda, i to da bude: Usvajanje deklaracije o saradnji sa Haškim tribunalom, jer živimo na jednom području gde su stalna iznenadjenja ..... prisutna i očekujem da će ponovo nešto novo iznenadjujuće da se desi a da se ne dešava ovde na Skupštini ja predlažem da za sledeću sednicu usvojimo ovu tačku dnevnog reda.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Falemnderit zoti deputet. Kryesia do ta shqyrtojë këtë çështje.

Më lejoni t'i mbyll punimet e kësaj seance. Ju falemnderit.

Seanca përfundoi punën në orën 12,20.

---

E transkriptoi: (1-43) RT/Zyra E04, tel: 211-860